

Krasitja e Mollës

Krasitja dhe mirëmbajtja e rregullt është çelësi i suksesit për një rendiment të lartë

Cili është qëllimi i krasitjes?

- Të mbajmë vitalitetin e bimës;
- Të kufizojmë rritjen duke larguar 20-30% të degëve dhe duke formësuar dhe mirëmbajtur kurorën e fidanit që nga fillimi e deri në fund të ciklit jetësor;
- Të kemi një formë kurore frytdhënëse, e cila më vonë mund të mirëmbahet lehtë;
- Të përmirësojmë cilësinë e lulëzimit, frytdhënies, gjethit dhe kurorës;
- Të stimulojmë rritjen e degëzave të reja për një prodhim kualitativ në vegjetacionin të ardhshëm.

Kur duhet të bëhet krasitja?

Krasitja dimërore kryhet gjatë periudhës së pushimit relativ të bimës (prej rënies së gjetheve e deri në pranverë, gjegjësisht para fillimit të hapjes së sythave)

Si bëhet krasitja?

Zakonisht kultivarët e mollës prodhojnë pjesën dërmuese të frutave mbi degë njëvjeçare (degët e përziera ose ato të holla), prandaj krasitja duhet të bëhet në përputhje me veçoritë e kultivarit, kushtet e kultivimit dhe fuqinë e rritjes së pemëve.

Metoda e krasitjes së thjeshtë përfshinë 3 hapa kryesorë:

1. Pastrimin: Hapi i parë është të përcaktohet forma e kurorës duke lënë degët e nevojshme për formën skeletore. Me krasitje duhet të krijohet një kurorë e ajrosur dhe duhet lënë degët me kapacitet të lartë për fotosintezë.
2. Rrallimin: Me hapin e dytë duhet pastruar (rralluar) pemën nga degët e dëmtuara, të thyera ose të thara, dhe të formojmë shtyllën bazë të kurorës kultivuese, e cila është e qëndrueshme t'i mbajë të gjitha frutat.
3. Finalizimin: Me krasitje eliminohen të gjithë thithakët, degëzat me pak sytha, degët me plagë të ndryshme dhe degët e sëmura.

Vërejtje!

- Mos e teproni me zvogëlimin e numrit të sythave frytdhënës sepse do të ndikojë në ulje të rendimentit.
- Mbani pastër, dezinfektoni dhe mbrehni mjetet e krasitjes.
- Mbroni me preparat adekuat degët e prera.
- Bëni prerjen duke u larguar 5 mm nga sythi i fundit.
- Largoni të gjitha degët dhe mbetjet e drunjëve nga pemishtja.
- Mbrojeni pemishten me preparate të spërkatjes dimërore menjëherë pas krasitjes.